



**GJIMNAZI I PËRGJITHSHËM DITOR NR 4**  
**RREGULLORJA E BRENDSHME SHKOLLORE**

## **IDENTITETI I SHKOLLËS**

**Drejtoria e Arsimit të Mesëm A' Athinë**

**Kodi i Shkollës: 0551070**

**Adresa e Shkollës: Μαιζώνος(Mezonos) 21-29 &**

**Σωνιέρου(Sonieru) 3-5 Nr.Tel.: 2108838441**

**e-mail: mail@4lyk-athin.att.sch.gr**

**Faqe elektronike:[http://:4lyk.athin-new.att.sch.gr](http://4lyk.athin-new.att.sch.gr)**

**Drejtoresha e Shkollës: Steiakaki Maria**

**Nëndrejtoresha: Barkura Eleni**

## **Hyrje**

Rregullorja e Brendshme e Funkcionimit të Shkollës (neni 37, N.4692/2020) ka si qëllim të sigurojë kushtet dhe termat e nevojshme që të realizohet sa më mirë të jetë e mundur puna e shkollës dhe të arrihen sa më mirë të jetë e mundur objektivat që caktojmë çdo herë si komunitet shkollor (nxënës, arsimtarë, personel shkencor, personel ndihmës, prindër/kujdestarë). Rregullorja bazohet në çka parashikohen nga Shteti për arsimin dhe funksionimin e Shkollave publike dhe private, përfshin parime pedagogjike të pranuar dhe është e përshtatur në kushtet e veçanta të funksionimit të Shkollës dhe me karakteristikat e komunitetit shkollor lokal dhe atij më të gjerë.

### ***Hartimi, aprovimi dhe pajtueshmëria me Rregulloren.***

Rregullorja e Brendshme e Funkcionimit u hartua pas sugjerimit të Drejtorit/Drejtoreshës së Shkollës ose të Mbikqyrësit/Mbikqyrëses, me pjesëmarrjen e të gjithë anëtarëve të Shoqatës Pedagogjike, të Kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit prej 15 anëtarësh. Është aprovuar nga Koordinatorin /Koordinatorja e Projektit Arsimor që ka përgjegjësinë pedagogjike të shkollës sonë si edhe nga Drejtori/Drejtoresha e Arsimit.

Rregullorja e Brendshme e Funkcionimit me fillimin e vitit shkollor ju njoftohet të gjithë prindërve/kujdestarëve dhe shpallet në fillim të vitit shkollor në faqen elektronike të shkollës. Një formë përmbledhëse e kësaj rregulloreje shpallet në çdo klasë dhe diskutohet tërësisht me të gjithë nxënësit/nxënëset e Shkollës.

Respektimi i saktë i saj përbën përgjegjësi dhe detyrim për të gjithë anëtarët e komunitetit tonë shkollor: të drejtorisë së Shkollës, të arsimtarëve dhe të personelit ndihmës, të nxënësve, të prindërve dhe kujdestarëve.

Rregullorja përditësohet herë pas here ,nëpërmjet procedurës së parashikuar nga ligji me pjesëmarrjen e të gjithë anëtarëve të komunitetit shkollor, në mënyrë të tillë që të përfshijë rregulla të reja ligjore, tu përgjigjet ndryshimeve të kushteve të funksionimit të Shkollës dhe herë pas here vendimeve të organeve përkatëse kolektive.

## **1. Parimet bazë dhe objektivat e Rregullores së Brendshme të Funkcionimit**

Rregullorja përmban kushte dhe rregulla, ndarje të përgjegjësive dhe të kompetencave, të të drejtave dhe detyrimeve, për të gjithë anëtarët e komunitetit shkollor në mënyrë të tillë që të krijohet në shkollë një klimë pedagogjike dhe edukuese që lehtëson funksionimin metodik, rezultativ dhe pa pengesa të saj. Njëkohësisht, vështirësitë dhe problemet që dalin trajtohen nga anëtarët e komunitetit shkollor si sfida dhe mundësi përmirësimi, zhvillimi dhe fuqizimi të praktikave pedagogjike, mësimore dhe të praktikave të tjera.

Objektivat bazë të Rregullores janë nxënësit/nxënëset të formojnë personalitetin e tyre, të arsimohen me mënyrën më të mirë të mundshme dhe të fitojnë aftësi të cilat kanë si rol bazë dhe kryesor procedurën mësimore dhe njëkohësisht përbëjnë aftësi për jetën, siç janë krijimtaria, vetëkontrolli, ndjenja e përgjegjësisë, bashkëpunimi, ndjeshmëria, respekti reciprok, mirëkuptimi reciprok, respektimi i diversitetit, respektimi ndaj rregullave të përbashkëta të caktuara, ndërgjegjja mjedisore, mbrojtja e shëndetit, si edhe konsolidimi i barazisë, solidaritetit, dhe demokracisë.

Nëpërmjet parimeve/orientimeve të dakorduara të Rregullores së Shkollës sonë kërkohet:

- Të sigurohet një hapësirë mbështetëse për t'u realizuar me sukses puna arsimore dhe pjesëmarrja e papenguar e të gjithëve në procedurën arsimore.
- Të kultivohet klimë e përshtatshme për zhvillimin e personalitetit të nxënësit/nxënëses por dhe të të gjithë anëtarëve të komunitetit shkollor.
- Të sigurohet shëndeti fizik dhe mendor i të gjithë anëtarëve të komunitetit shkollor.
- Të krijohen bazat për kushte dinjitoze dhe efikase mësimdhënieje, mësimnxënieje dhe pune.

## **2. Funksionimi i shkollës**

### **I. Orari i mësimdhënies**

Fillimi,përfundimi,kohëzgjatja e mësimëve të programit të detyrueshëm si edhe pushimet përcaktohen nga vendimi përkatës i Ministrisë së Arsimit dhe njofthet në faqen elektronike të Shkollës.Viti shkollor caktohet nga Dt 1 Shtator e çdo viti dhe përfundon më 30 Qershor të vitit të ardhshëm.

### **II. Mbërritja në Shkollë**

Nxënësit mbërrijnë në Shkollë të paktën 5 minuta para fillimit të mësimit.Mësimi fillon në 08.05 me qëllim evitimin e grumbullimit të nxënësve me nxënësit e shkollës të bashkëstrehuar dhe përfundon në orën 14.00. Pas grumbullimit të mëngjesit porta e shkollës qëndron e hapur për mbërritjet e vonuara deri në përfundimin e orës se 1-rë të mësimit. Ata që mbërrijnë me vonesë,paraqiten fillimisht në zyrën e Drejtorisë. Më pas qëndrojnë në mjedisin e duhur të Shkollës ose nëse pranoen nga pedagogu, futen në klasë me qëllim që ndjekin mësimin pasi kanë marrë mungesë.

### **III. Qëndrimi në Shkollë**

Nxënësit duhet të futen në klasë menjëherë sapo tingëllon zilja.Vendet e nxënësve në klasë përcaktohen sipas zgjedhjes së tyre.Ndryshimi i vendit lejohet nga pedagogu me qëllim zhvillimin normal të procedurës së mësimdhënies/mësimit . Gjatë kohës së mësimëve asnjë nxënës që ka hyrë në shkollë nuk lejohet të mungojë pa arsye nga klasa e mësimit.

Nuk lejohet konsumimi i ushqimit, kafes dhe pijes freskuese në klasën e mësimit.

#### **IV. Largimi nga Shkolla**

Nxënësit/nxënëset në asnjë mënyrë nuk largohen nga Shkolla pa leje, para përfundimit të mësimeve. Nëse paraqitet nevojë e largimit emergjent gjatë kohës së orarit shkollor (psh sëmundje) informohet prindi/kujdestari dhe në rast se konsiderohet e domosdoshme mbërrin vetë në shkollë për të marrë fëmijën e tij.

Së fundmi nëse ndonjë prind/kujdestar ka nevojë për arsye specifike të marrë fëmijën përpara përfundimit të mësimeve, duhet të informojë Drejtorinë e Shkollës.

#### **V. Orari Shkollor**

Shkolla jonë zbaton Orarin Shkollor, siç është përcaktuar nga buletinet e Ministrisë së Arsimit.

#### **VI. Mungesat e nxënësve**

Për ndjekjen e rregullt të studimit prej nxënësve përgjegjësia bie plotësisht mbi kujdestarët e tyre. Prindët/kujdestarët kanë për detyrë të informojnë Shkollën për mungesën e fëmijëve të tyre.

#### **VII. Procedurat e informimit të nxënësve, prindërve dhe kujdestarëve**

Informimi i nxënësve, prindërve dhe kujdestarëve bëhet nëpërmjet mënyrave të mëposhtme:

- Shënimeve informuese, shkresa ose shënime elektronike për realizimin e ekskursioneve arsimore, për ndjekjen e aktiviteteve arsimore etj.
- Nëpërmjet telefonit në raste të veçanta.
- Nëpërmjet vizitës së tyre në Shkollë në ditët dhe orët e përcaktuara nga Shoqata e Arsimitarëve.

Veçanërisht për informimin e nxënësve propozohet edhe informimi nëpërmjet faqes elektronike të shkollës.

### **3. Jeta shkollore dhe sociale**

#### **I. Studimi**

Studimi i nxënësve, në përputhje me legjislaturën në fuqi, është detyrë dhe detyrim i tyre. Pjesëmarrja e tyre duhet të jetë e rregullt, aktive dhe sistematike. Studimi me mungesa dhe vecanërisht pa arsye serioze, vështirëson punën shkollore dhe përparimin e tyre.

#### **II. Mjediset Shkollore**

Bashkëpunimi i të gjithëve është i domosdoshëm, që të ruhet një mjedis i pastër dhe i kënaqshëm, i përshtatshëm për mësim. Për suksesin e këtij objekti nxënësit:

- Respektojnë pasurinë e luajtshme dhe të paluajtshme të Shkollës si edhe mjedisin natyral të oborrit të Shkollës.

- Nuk ndotin mjedisin shkollor, nuk shkruajnë mbi banka dhe mure, përdorin koshat e mbeturinave.

- Mbajnë bankën e tyre të pastër në gjendje të shkëlqyer.

Theksohet që nxënësi që shkakton dëm në pasurinë e Shkollës, kontrollohet për këtë sjellje dhe kostoja e riparimit rëndon mbi kujdestarin e tij.

### **III. Pushimi**

Gjatë kohës së pushimit nxënësit/nxënëset, nëse kanë nevojë të shkojnë në tualet ose në mensë ose të pinë ujë, mund të zbresin poshtë, përndryshe duhet të dalin në oborrin e katit të sipërm për evitimin e grumbullimit në klasat mësimore dhe në korridore dhe të ajrimit të mjaftueshëm të ambjentit.

Me përfundimin e çdo ore mësimore arsimtari/arsimtarja largohet i/e fundit përderisa dalin më parë të gjithë nxënësit.

Në rastet e kushteve të këqija klimaterike nxënësit qëndrojnë në korridore ose në sallën e shkollës.

Pushimi është kohë loje, zhvillimi marëdhëniesh shoqërore por edhe kohë për plotësimin e nevojave fizike (ushqim, ujë, tualet). Nxënësit/nxënëset bashkëveprojnë dhe për çdo problem ose vështirësi që ata takojnë drejtohen tek arsimtari në detyrë, që ndodhet aty.

### **IV. Paraqitja**

Paraqitja e nxënësve duhet të jetë e denjë. Duhet të evitohen fenomene të demonstrimit, provokimit, dhe të ekzagjerimit që nuk përkojnë me statusin e nxënësit/nxënësve.

### **V. Sjellja-Të Drejtat-Detyrimet**

#### **Drejtori:**

- Është përgjegjës bashkë me arsimtarët, për pastërtinë dhe estetikën e mjediseve të shkollës, si edhe për mbrojtjen e shëndetit dhe të sigurisë së nxënësve.
- Informon Shoqatën e Arsimitarëve/Arsimtareve dhe Nxënësve për legjislaturën arsimore, buletinet dhe vendimet që lidhen me funksionimin e Shkollës dhe zbatimin e programeve arsimore.
- Kontribuon në krijimin e klimës së sjelljes demokratike të Arsimitarëve dhe të nxënësve, dhe është përgjegjës në bashkëpunim me arsimtarët, për ruajtjen e disiplinës.
- U drejton arsimtarëve, sugjerime me frymë solidariteti mes kolegësh, kur është e nevojshme.
- Kujdesohet për sigurimin e kushteve dhe mjeteve pedagogjike, për përdorimin e mirë të tyre në klasën shkollore, funksionimin e tyre dhe zëvendësimin e tyre në rast konsumimi/dëmtimi.

#### **Arsimtarët**

Arsimtarët duhet të:

- Sigurojnë mbrojtjen dhe shëndetin e nxënësve brenda shkollës, si edhe gjatë ekskursioneve dhe aktiviteteve shkollore.
- Trajtojnë nxënësit me mirësjellje, mirëkuptim, respekt ndaj personalitetit të tyre, duke evituar vërejtje ose qortime të ekzagjeruara.
- Kontribuojnë në krijimin e një klime shkollore që krijon tek nxënësit ndjenja sigurie, besimi dhe komforti me qëllim që të drejtohen tek arsimtarët për ndihmë kur përballen me ndonjë problem.

- Trajtojnë nxënësit me frymë demokratike, me barazi, drejtësi dhe nuk bëjnë dallime pro ose kundër disa nxënësve të caktuar as të imponojnë pikëpamjen e tyre personale.
- Kultivojnë dhe frymëzojnë tek ata, kryesisht me shembullin e tyre, sjellje demokratike.
- U mësojnë nxënësve subjektet e ndryshme të dijes në përputhje me programin në fuqi dhe të edukojnë dhe mësojnë nxënësit në përputhje me qëllimet dhe objektivat e sistemit tonë arsimor.
- Përgatisin mësimin e ditës në mënyrë të tillë që të nxisin interesin e nxënësve dhe të zbatojnë metoda bashkëkohore dhe të përshtatshme mësimdhënieje në bazë të nevojave e nxënësve dhe veçantive të subjekteve të dijes.
- Vlerësojnë objektivisht përparimin dhe rezultatet e nxënësve.
- Interesohen për kushtet e jetës së nxënësve në familje dhe në mjedisin më të gjerë shoqëror, marrin në konsideratë faktorët që ndikojnë në përparimin dhe sjelljen e nxënësve të tyre dhe ndërmarrin veprimet e duhura pedagogjike, në mënyrë që të përballohen probleme të mundshme me respekt, maturi dhe takt.
- Inkurajojnë nxënësit të marrin pjesë aktivisht në formimin dhe marrjen e vendimeve për tema që u përkasin atyre dhe shkollës dhe kultivojnë frymën e solidaritetit dhe të bashkimit.
- Janë korrektë në mbërritjen e tyre në shkollë dhe me orën e fillimit dhe përfundimit të mësimëve.
- Janë të veshur me dinjitet.
- Bashkëpunojnë me Drejtorin/Drejtoreshën, me prindët dhe kompetentët e Këshillit të Kontrollit dhe Komunikimit për trajnimin më të mirë të mundshëm pedagogjik të problemeve të sjelljes duke respektuar personalitetin dhe të drejtat e nxënësve.
- Rinovojnë dhe pasurojnë dijet e tyre, në lidhje me subjekte të ndryshme të dijes nëpërmjet mënyrave të ndryshme të kualifikimit dhe orientimit shkencor pedagogjik që ofrohen nga sistemi i organizuar arsimor ashtu si edhe me vetë kualifikim.
- Kujdesen për krijimin e klimës së bashkëpunimit harmonik, të komunikimit të vazhdueshëm reciprok me prindërit dhe kujdestarët e nxënësve dhe i informojnë për studimin, edukimin dhe rezultatet e fëmijve të tyre.

#### ***Nxënësit/Nxënëset:***

Sjellja e nxënësve duhet të përshkohet nga morali demokratik, respekti ndaj personelit arsimor, administrativ dhe ndihmës, ndaj nxënësve të tjerë të shkollës, ndaj pasurisë së shkollës si edhe ndaj personalitetit të tyre. Ndalohet çdo formë dhune, verbale, fizike, psikologjike ose dhunë e ndonjë forme tjetër. Nxënësit duhet të:

- Tregojnë respekt, me fjalët dhe veprimet e tyre, ndaj çdo anëtari të komunitetit shkollor.
- Pranojnë që çdo mësim ka vlerën e tij të veçantë të edukimit dhe të japin në çdo njërin prej tyre vëmendjen e kërkuar.
- Mbështesin dhe kërkojnë pjesëmarrjen demokratike të tyre në procedurat e marrjes së vendimeve në kuadër e kompetencave që u jep atyre legjislatura, duke kontribuar në zbatimin e këtyre vendimeve.

- Kontribuojnë në krijimin e një klime të qetë, pozitive, bashkëpunuese, përfshirëse, konstruktive në shkollë.
- Kujdesen për të gjithë mjediset e Shkollës dhe i ruajnë ato të pastra.
- Mbrojtja e ndërtesës së shkollës dhe e pasurisë së saj është çështje e të gjithëve. Nëse shkaktohet ndonjë dëmtim/dëm, ai duhet të restaurohet nga shkaktari/shkaktarja.
- Përpiqen të kontribuojnë në adoptimin e praktikave zhvilluese, si kursimi i energjisë, riciklimi i materialeve dhe përdorimi i duhur i mjeteve mësimore.
- Përpiqen të zgjidhin kontradiktat ose mosmarrëveshjet me dialog, duke ndjekur me rradhë hapat e mëposhtme:
  1. Diskutojnë menjëherë dhe paqësisht me atë që kanë mosmarrëveshjen.
  2. Drejtohen tek arsimtari përgjegjës i klasës ose tek Këshilltari i Jetës Shkollore.
  3. Drejtohen tek Drejtori/Drejtoresha.
- Në rastet që mbi ta ushtrohet sjellje e dhunës verbale, psikologjike ose fizike ose janë dëshmitarë të një sjellje të tillë reagojnë menjëherë dhe ndjekin hapat e mësipërme.
- Gjatë kohës së mësimave zbatojnë rregullat e klasës. Marrin pjesë aktivisht në procedurën arsimore mësimore të përditshme dhe nuk pengojnë mësimin duke respektuar të drejtën e nxënësve të tjerë të klasës, në mësim.
- Drejtohen tek pedagogët/pedagoget dhe tek Drejtorja e Shkollës dhe kërkojnë ndihmën e tyre, për çdo problem që i prekuron dhe u krijon pengesë për jetën e qetë dhe rezultative shkollore si dhe për përparimin e tyre.
  - Kur ekziston nevoja, mund të komunikojnë me prindët e tyre, nëpërmjet telefonave të Shkollës, pasi kanë kërkuar leje.
- Në aktivitetet shkollore dhe festat por edhe në vizitat mësimore jashtëshkollore ndjekin arsimtarët shoqëruar dhe sillen me edukatë dinjitet.
- Libri shkollos është krijim intelektual, ofrohet falas nga Shteti dhe nuk duhet të shkatërrohet.

## **VI. Tema të tjera**

Theksohet që:

- Përdorimi i telefonit celular për bisedë, regjistrim video ose çdo përdorim tjetër brenda mjedisëve të Shkollës-ndërtesave dhe mjedisëve të jashtë të saj- ndalohe.
- Pirja e duhanit, pirja e alkolit ose përdorimi i lëndëve të tjera vartëse ndalohen si për nxënësit edhe për pedagogët. Shkelja e këtyre rregullave nënkupton zbatimin e menjëhershëm të masave pedagogjike.

## **VII. Kontrolli pedagogjik**

Zhvillimi i klimës pozitive shkollore është një faktor i rëndësishëm i procedurës së trajtimit të shkeljeve në mjedisin shkollos. Ndërkaq, janë të shumta rastet ku nxënësit/nxënëset veprojnë me sjellje të paparanueshme në lidhje me rregulloren e funksionimit. Çështjet e sjelljeve të paparanueshme të nxënësve/nxënëseve në Shkollë përbëjnë objekt bashkëpunimi të prindëve/kujdestarëve me arsimtarin/arsimtarene e klasës, Këshilltarin/Këshilltarene e Jetës Shkollore, Drejtorin/Drejtoreshën e Shkollës, Shoqatën Pedagogjike dhe me Koordinatorin e Punës Pedagogjike, me qëllim që të ekzistojë trajtimi më i mirë i mundshëm pedagogjik i çështjes. Në çdo rast dhe përpara çdo vendimi merret në konsideratë parimi bazë, i respektit të personalitetit dhe të drejtave të fëmijës. Ndëshkimet fizike nuk lejohen.



Shkolla si institucion edukimi, ka për detyrë të funksionojë në mënyrë të tillë që nxënësit/nxënëset të ndërgjegjësohen, që çdo veprim ka pasoja, të mësojnë të marrin përgjegjësinë e zgjedhjeve të tyre dhe të bëhen qytetarë të përgjegjshëm. Nëse sjellja e nxënësit/nxënëses nuk përkon me pozicionin e tij/saj dhe devijon nga zbatimi i rregullores së brendshme të Shkollës, atëherë përballet me kontrollin pedagogjik në përputhje me parimet e psikologjisë dhe pedagogjisë që i përkasin moshës së tij/saj. Çështjet e sjelljes me shkelje në Shkollë të nxënësve/nxënëseve përballohen në bazë të legjislaturës në fuqi.

### **VIII. Aktivitete Shkollore**

Shkolla organizon një sërë aktivitete brenda dhe jashtë Shkollës që si qëllim kanë ndërthurjen e jetës shkollore dhe sociale, dhe për këtë është e nevojshme të ketë në fillim të vitit shkollor planifikimi që do të marrë në konsideratë kritere pedagogjike. Nëpërmjet këtyre aktiviteteve fëmijët pasurojnë dijet tashmë ekzistuese, i lidhin me jetën e përditshme, fitojnë aftësi për jetën, fitojnë sensibilitet në çështje të ndryshme sociale, zgjerojnë horizontet e tyre dhe bëjnë praktikë ato që mësojnë tek Programet e Aktiviteteve Shkollore dhe në Labororet e Aftësive të ndryshme. Shkolla ka si qëllim sensibilizimin e prindërve/kujdestarëve dhe pjesëmarrjen e të gjithë nxënësve/nxënëseve në aktivitetet festive, edukative, kulturore, sportive.

### **IX. Çështje të tjera**

#### **Humbje monetare (parash) ose sendesh me vlerë**

Shkolla nuk mban përgjegjësi në rast humbje parash ose sendesh me vlerë që nxënësit ndoshta kanë patur me vete.

## **4. Komunikimi dhe Bashkëpunimi Prindër/Kujdestarë-Shkollë**

### **I. Rëndësia e komunikimit dhe bashkëpunimit Shkollë-Familje**

Një faktor shumë i rëndësishëm i funksionimit total të Shkollës dhe i klimës që krijohet është komunikimi dhe bashkëpunimi konstruktiv me prindët/kujdestarët e nxënësve/nxënëseve dhe me Shoqatën e Prindërve. Besimi i fëmijës tek Shkolla përforcohet nga qëndrimi pozitiv i prindërve/kujdestarëve ndaj Shkollës dhe Arsimit. Prindët/Kujdestarët është e rëndësishme të bashkëpunojnë ngushtë me Shkollën, me qëllim që të ndjekin rregullisht edukimin dhe rezultatet e fëmijve të tyre, duke marrë pjesë në takimet informuese që organizohen nga Shkolla. Konsiderohet i vetëkuptueshm bashkëpunimi i ngushtë dhe komunikimi i prindërve/kujdestarëve me arsimtarët dhe Drejtorin/Drejtoreshën e Shkollës për zgjidhjen e çështjeve që mund të lindin.

### **II. Rëndësia e bashkëveprimit të të gjithëve**

*Një Shkollë e hapur, bashkëpunuese, përfshirëse dhe demokratike ka nevojë për bashkëveprimin e të gjithëve-*

*nxënësve/nxënëseve, arsimtarëve, Drejtorit/Drejtoreshës, Kujdestarëve,*

*Komisionit Shkollor, Pushtetit Lokal- që të realizojë misionin e saj.*

## **5. Politika e Shkollës për mbrojtjen nga rreziqet e mundshme**

### **I. Përballimi i nevojave emergjente**

Drejtori/Drejtoresha e Shkollës, në fillim të vitit shkollor në bashkëpunim me Shoqatën Pedagogjike të Shkollës,ndërmerr veprimet e nevojshme të parashikuara për përballimin e nevojave emergjente brenda mjedisit shkollor.

Në rastet e nevojës emergjente asnjë fëmijë nuk largohet nga Shkolla i vetëm.

Përssa i përket mbrojtjes nga tërmetet dhe fenomeneve natyrale ,konfirmohet rregullisht Plani i Veprimeve të Memorandumit për administrimin e Rrezikut të Shkollës nga Tërmeti,me realizimin e ushtrimeve të gatishmërisë gjatë vitit shkollor.

Gjithashtu Drejtori/Drejtoresha informon nxënësit/nxënëset si edhe prindët/kujdestarët,për rregullat bazë dhe mënyrat e reagimit gjatë shfaqjes së këtyre fenomeneve.

Gjatë tre javëve të para të fillimit të vitit mësimor,zhvillohet seminar për ndihmën e shpejtë me pjesëmarrjen aktive të nxënësve dhe caktohet një nxënës Përgjegjës për zbrazen e mjedisit.

Së fundmi ,në gjendje pandemie ose fenomeneve të rrezikshme -ekstreme arsimtarët,nxënësit/nxënëset,prindët/kujdestarët,Drejtorët/Drejtoreshat,Mbikqyrësit/Mbikqyrëset duhet të pajtohen dhe të ndjekin rigorozisht udhëzimet që nxjerrin institucionet përkatëse psh Organizata Kombëtare e Shëndetit Publik, Ministria e Arsimit,Ministria e Mbrojtjes së Qytetarit etj për funksionimin e duhur të Njësisë Shkollore dhe sigurinë e anëtarëve të saj.

Në rast të shfaqjes së një jashtëshkollori në mjedisin e shkollës informohet menjëherë pedagogu në detyrë dhe Drejtorja e Shkollës.

### **II.Plan specifik largimi për shkak të kushteve emergjente**

Në rast nevoje emergjente,për sigurinë e fëmijëve është krijuar plan largimi dhe realizohen ushtrime gatishmërie në fillim por dhe gjatë vitit shkollor.

## **6. Rregullat e Arsimit në Distançë**

Në rast se pezullohet funksionimi i shkollave mësimet kryhen nëpërmjet arsimit në distancë.Gjatë kohës të arsimit në distancë:

1. Nxënësit futen në sistem me të dhënat e tyre të vërteta.Nëse Arsimtari konstaton që nxënësi nuk përdor identitetin e tij real mund ta përjashtojë.
2. Pritja në Lobby mund të jetë maksimumi 5 minuta,përveç nëse ekzistojnë arsye serioze.
3. Nxënësit që të marrin fjalën, ngrenë dorën duke përdorur mjetin përkatës dhe i dërgojnë arsimtarit mesazh të shkruar për të sqaruar paqartësitë dhe për të zgjidhur probleme teknike të mundshme.
4. Përdoret për mësimdhënie edhe platforma dixhitale e class.
5. Në rast se për ndonjë arsye sistemi nuk funksionon përdoret në mënyrë alternative platforma e-lessons.

## **7. Rregullore e Brendshme Funksonimi-Procedurat e sigurimit të zbatimit të saj**

Rregullorja e pranuar bashkërisht, bazohet në legjislaturën në fuqi dhe në parimet pedagogjike dhe arsimore bashkëkohore. Zbatimi i saj nga të gjithë faktorët e Shkollës (nxënës/nxënëse, arsimtarë, personel tjetër shkencor, prindër/kujdestarë), me respekt reciprok ndaj rolit të tyre të veçantë institucional, në mënyrë që të ketë plotësi, pranim dhe zbatim të përgjithshëm, përbën kusht për funksionimin e rregullt të Shkollës. Është Themeli mbi të cilin Shkolla mund të ndërtojë që të realizojë objektivat dhe vizionin e saj.

Çështje që lindin dhe nuk parashikohen nga Rregullorja, përballohen sipas rastit nga Drejtori/Drejtoresha dhe Shoqata Pedagogjike, në përputhje me parimet e shkencës pedagogjike dhe legjislaturën arsimore, me frymë bashkëpunimi me të gjithë anëtarët e komunitetit shkollor.

Rregullorja u njoftohet të gjithë prindërve/kujdestarëve dhe të gjithë nxënësve/nxënëseve me qëllim informimin e tyre.

Rregullorja e Brendshme Shkollore u konfirmua me vendim unanim të Shoqatës së Mësimdhënësve (Akti 17/14-9-2023)

Drejtoresha

Steiakaki Maria

Kimiste